

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI KONTRAKTOR

DREJTORIA RAJONALE OSSH sh.a FIER

Adresa : Lagja "1 Maj", Rr. "Enriko Veizi", Fier"

Nr. _____ Prot.

Fier, më __ / __ /2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje transversa metalike LTM dhe LTU” “

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KODI CPV - Materiale elektrike 31681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

55,996,750(pesedhjetë e pese milion e nentëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesedhjetë) leke pa TVSH.

Ndarje ne Lote - Nuk ka

Arsyeja pse është marre vendim në lidhje me mosparashikimin e ndarjes në lote është se elementet e kësaj procedure prokurimi, janë të ndërlidhura me njëra-tjetren dhe për këtë arsye, kjo procedurë nuk mund të ndahet në Lote, pasi krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa Operatore Ekonomik mund të sjellë përdorshmeri të përkohshme ose vonesa të shumta në funksionimin e pajisjeve dhe materialeve të cilat mund të furnizohen nga një tjetër Operator Ekonomik, kontraktor i një loti tjetër.

AK nuk mund të disponojë një element nga mallrat objekt prokurimi në vete dhe të presë furnizimin e mallrave të tjerë, në qoftë se këto janë të ndara në lote.

Gjithashtu, vonesat që mund të shkaktohen nga marrëdhënia me disa operatorë ekonomike mund të vështirësojë edhe nevojat e AK për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2021, 2022, 2023 të konfirmuara me vule prane administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlera të xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Gjithashtu në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e

taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vertetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se **40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës perkatesisht 22,398,700 (njëzet e dy milion e treqind e nentëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) leke pa tvsh .**

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar që është brenda vlerës së përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jete jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet .

Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Dokumentacioni

Per mallrat objekt prokurimi - Blerje tranversa metalike LTM dhe LTU”

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqese autorizim të prodhuesit / distributorit për mallin e kërkuar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik duhet të paraqese: Katalogun/et ose fragmente të katalogut /eve të prodhuesit/ve për mallrat objekt prokurimi ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. *Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*

Argumentim: Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Operatori Ekonomik duhet të paraqese dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vertetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara (lista e mësipërme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen që të shërbejnë AK-se, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme si aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe çdo element tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, Operatorët Ekonomikë, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, leshuar nga institucione të autorizuar, ose nga prodhuesi, për mallrat e cituar më sipër, për të krijuar bindjen se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara. Është në të drejtën e AK të kërkojë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare që vertetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të vendosura, përpara se AK të bejë përzgjedhjen e OE-se fituese. Kjo kërkesë është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikate të vlefshme që verteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit të cilësive se tij është në përputhje me ISO 9001 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kerkuara. Në rast bashkimi të operatoreve ekonomike, secili anetar duhet të paraqesë certifikatat ISO të sipercituara

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësive ISO 9001 është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të vertetuar dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetedeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësive të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kerkuara.

Argumentimi: Ky kriter është kërkuar pasi vetëm prodhuesi mund të vërtetojë se produktet e prodhuara kanë në fakt, karakteristikat e deklaruara. Certifikata e sigurimit të cilësisë ka për qëllim të plotësojë deklaratën fillestare apo certifikatën e përshtatshmërisë. Si provë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e produktit, prodhuesi pajiset me certifikatën për cilësinë e sistemit të kontrollit i cili monitoron fabrikimin e produkteve të caktuara. Këto certifikata bazohen në standardet ndërkombëtare ISO 9001: 2000.

6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së konformitetit për produktet që kërkohen me sipër, është një kërkesë e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës dhe duke qenë se, Autoriteti Kontraktor është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se OE-te pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësive të mallit që do të ofrohet, rrjedhimisht është e drejtë e AK-se të kërkojë ofertuesve që të paraqesin deklaratë për të vertetuar konformitetin prodhimit të produkteve të procedurës e prokurimit. Për Autoritetin Kontraktor është e nevojshme që, Operatorët ekonomikë gjatë ofertimit të tyre të provojnë se zotërojnë kapacitetet teknike lidhur me deklaratën e konformitetit për artikujt e kerkuara me sipër. Kërkesa e mesipërme ka si qëllim të sigurojë AK-ne, mbi aftësitë teknike të OE fitues në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standarteve të mirepërcaktuara në DST. Ky kriter nuk është diskriminues dhe është proporcional me objektin e kontratës, si dhe është në zbatim të Nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

7. Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin / Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

- *Specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i specialisteve, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.*
- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **Data 16.07 .2024 Ora 11.00 vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

Njësia e Prokurimit

